

**GJYKATËS SË APELIT TË KOSOVËS**  
përmes **GJYKATËS THEMELORE TË PRISHTINËS**  
DEPARTAMENTIT PËR ÇËSHTJE EKONOMIKE

lidhur me lëndën **II EK nr. 316/20**

*Paditëse-propozuese:*

**Federata Sindikale e Pavarur e PTK-së («Sindikata»)**  
Lagjja Dardania p.n., 10010 Prishtinë  
përfaqësuar nga juristët Getoar Mjeku e Blerim Sallahu

*i paditur-kundërprozues:*

**DARDAFON.net L.L.C. («Z Mobile»)**  
Rr. Dëshmori p.n., Miradi e Epërme, 12010 Fushë-Kosovë  
përfaqësuar nga avokati Virtyt Ibrahimaga  
Rr. Anton Çetta nr. 1/16, 10010 Prishtinë

## **ANKESË E PADITËSE-PROPOZUESES**

*baza juridike:* Ligji për procedurën kontestimore, neni 206

*akti i goditur:* Aktvendim i 10 gushtit 2020 i Gjykatës Themelore të Prishtinës, për refuzimin e kërkesës për masa të sigurimit, dorëzuar më 19 gusht 2020

*për shkak të:* — shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore  
— konstatimit të gabuar a të paplotë të gjendjes faktike

Prishtinë, 25 gusht 2020

**Dr. Getoar Mjeku, jur.**

Rr. Enver Maloku nr. 15, 10000 Prishtinë  
+383 45 30 52 00 | [gm@getoar.com](mailto:gm@getoar.com)

## **Përmbajtja**

<b>I. HYRJE.....</b>	<b>3</b>
A. Përmbledhje.....	3
B. Çështje për shqyrtim.....	4
C. Arsyetimi juridik.....	4
<b>II. PROCEDURA DHE FAKTET.....</b>	<b>5</b>
A. Palët.....	5
B. Marrëveshja e kontestuar.....	5
C. Padia dhe kërkesa për masa sigurimi.....	6
<b>III. PRETENDIMET ANKIMORE.....</b>	<b>7</b>
A. Shkelje procedurale: Themeloria nuk ka arsyetuar refuzimin.....	7
B. Themeloria ka shkelë normat për masa sigurimi: s'ka çmuar besueshmërinë e padisë, ka mohuar masat e lejuara.....	9
Në vend të besueshmërisë së padisë ka trajtuar masat e propozuara....	9
Ka konsideruar të paligjshme masat e parapara me ligj.....	10
Ka mohuar të drejtat e Sindikatës shkaku i palëve të tjera.....	12
Ka dalë jashtë kërkesës: Sindikata s'ka lypë masa nga neni 300.....	12
C. Keqkonstatimi i fakteve: Sindikata e Telekomit rrezikohen nga kërkesat e Z Mobiles, tjetërsimi i pasurisë dhe falimentimi.....	12
<b>IV. PËRMBYLLJE DHE PROPOZIM.....</b>	<b>14</b>

## I. HYRJE

### A. Përmbledhje

1. Sindikata e punëtorëve të Telekomit të Kosovës ka ngritur padi për vërtetimin e nulitetit të një kontrate mes Telekomit e Z Mobiles dhe ka kërkuar masa për të siguruar kërkesëpadinë dhe për të parandaluar dëmin. Gjykata Themelore ka refuzuar kërkesën për masa. Sindikata tani po ushtron ankesë ndaj aktvendimit të Themelores shkaku i shkeljeve të dispozitave të procedurës dhe keqkonstatimit të fakteve.
2. Themelorja ka shkelur rregullat e procedurës kontestimore, meqë nuk ka arsyetuar refuzimin e pretendimeve të Sindikatës dhe në vend se të vlerësojë besueshmërinë e padisë ka trajtuar natyrën e masave. Gjithashtu, ka konstatuar gabimisht dhe vetëm pjesërisht faktet, duke i shpërfillur dëshmitë për rrezikun e dëmit.
3. Sindikata ka përmbushur kushtet për masa të sigurimit sipas nenit 297 të Ligjit për procedurën kontestimore, duke parashtruar padi të besueshme dhe duke dëshmuar rrezikun e dëmit të pariparueshëm dhe të menjëhershëm. Padia e Sindikatës kërkon vërtetimin e nulitetit të kontratës, çka do t'i hapte rrugë kompensimit të dëmit — dhe sigurimi i kërkesëpadisë duhet të mundësojë mjetet për kompensim dhe të parandalojë dëmin e mëtejshëm. Sindikatës dhe Telekomit i kanoset rreziku i dëmit të ri nga përmbarimi i kërkesave të Z Mobiles, rreziku i tjetërsimit të pasurisë së Z Mobiles dhe rreziku i falimentimit të Telekomit.
4. Me këtë ankesë, Sindikata i kërkon Gjykatës së Apelit të ndryshojë aktvendimin e Themelores dhe të caktojë vetë masat e sigurimit që Z Mobiles ia ndalojnë:
  - (1) të vazhdojë, të negociojë ose të lidhë kontratë me Telekomin;
  - (2) të tjetërsojë pasuri me vlerë deri në 264 milionë euro;
  - (3) të pranojë përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga kontrata e 2009-tës; dhe
  - (4) të vazhdojë procedurat e nisura në kundërshtim me masat e sigurisë.

## B. Çështje për shqyrtim

5. Në shqyrtim para Gjykatës së Apelit janë këto çështje kryesore:

- (1) Arsyetimi i mangët a kundërthënës i aktvendimit përbën shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës.<sup>1</sup> Themelorja s'ka treguar pse ka refuzuar pretendimet, duke shpërfillur rrezikun që Z Mobile të tjetërsojë pasurinë, ta falimentojë Telekomin e t'i lërë punëtorët pa punë. A ka shkelur Themelorja dispozitat procedurale?
- (2) Gjykata shkel rregullat e procedurës kur duke i keqzbatuar ato pamundëson vendimin e ligjshëm e të drejtë.<sup>2</sup> Masa e sigurimit caktohet kur propozuesi dëshmon besueshmërinë e padisë dhe rrezikun e dëmit;<sup>3</sup> gjykata duhet të vendosë brenda kufijve të kërkesës.<sup>4</sup> Themelorja ka refuzuar besueshmërinë e padisë pa e marrë parasysh fare padinë; po ashtu, është thirrur në dispozita për masa që s'janë kërkuar. A ka gabuar Themelorja?
- (3) Ligji lejon ankesë kur gjykata vërteton gabimisht ose nuk vërteton fare një fakt vendimtar.<sup>5</sup> Gjykata Themelore ka mohuar rrezikun që kundërshtari ta vështirësojë realizimin e kërkesëpadisë, ndërsa nuk ka konstatuar fare rrezikun për dëm të mëtejshëm. Provat dëshmojnë se kundërshtari nuk ka klientë aktivë, andaj ka gjasa të tjetërsojë pasurinë; gjithashtu me kërkesat e veta mund të falimentojë Telekomin dhe t'i lërë sindikalistët pa punë. A ka gabuar shkalla e parë, duke shpërfillur këto fakte vendimtare?

## C. Arsyetimi juridik

6. Ligji lejon ankesë ndaj aktvendimit.<sup>6</sup> Ankesa i paraqitet shkallës së parë, e cila ia përcjell atë gjykatës ankimore.<sup>7</sup> Afati për masë dhe për raste ekonomike është 7 ditë.<sup>8</sup> Aktvendimi i 10 gushtit i është dorëzuar palës më 19 gusht, andaj ankesa është e afatshme.

---

1 Ligj 03/L-006 për procedurën kontestimore, GZRK 38/2008, ndryshuar me ligjin 04/L-118, GZRK 28/2012 (LPK), neni 182.2(n).

2 LPK, neni 182.1.

3 LPK, neni 297.

4 LPK, neni 2.1.

5 LPK, neni 181.1(b) lidhur me nenin 183.1.

6 LPK, nenet 206.1 dhe 208.

7 LPK, neni 185.

8 LPK, nenet 310.1 dhe 509(c).

## II. PROCEDURA DHE FAKTET

### A. Palët

7. Ankesën po e parashtron paditëse-propozuesja **Federata Sindikale e Pavarur e PTK-së**, e njohur shkurt si **Sindikata**. Sindikata është organizatë e rreth 3.500 punëtorëve të dy ndërmarrjeve publike në sektorin e komunikimeve elektronike e postare: Posta e Kosovës, SH.A., dhe Telekom i Kosovës, SH.A.
8. I paditur-kundërpropozuesi DARDAFON.net L.L.C., i njohur me emrin tregtar **Z Mobile**, është kompani private që ka rishitur shërbime të telefonisë mobile.
9. Telekom i Kosovës nuk është palë e paditur.

### B. Marrëveshja e kontestuar

10. Më 2009, Telekom i Kosovës dhe Z Mobile kanë lidhur Marrëveshjen e mbështetjes e operatorit të rrjetit mobil virtual (tutje «Marrëveshja»). Sipas Marrëveshjes, Z Mobile ka shfrytëzuar infrastrukturën e Telekomit, si operator amë, për të ofruar shërbime të telefonisë mobile.
11. Për mbi një dekadë, Telekom është detyruar t'i japë Z Mobiles qasje të pakufizuar në shërbime, ndërsa Z Mobile nuk ka mbuluar asnjëherë koston. Duke shitur nën çmim, duke mbajtur të hyrat për vete dhe duke rënduar rrjetin e Telekomit, Z Mobile ka dëmtuar gjithë industrinë e telekomunikacionit në vend, ka rrezikuar sigurinë shtetërore dhe ka sjellë Telekomin buzë falimentimit.<sup>9</sup>
12. Stafi i Telekomit ka llogaritur se Z Mobile ka përfituar rreth 83 milionë euro, ndërsa Telekom ka pësuar gati 264 milionë, si pasojë e Marrëveshjes.<sup>10</sup>
13. Marrëveshja ka përfunduar në korrik 2019, dhe veprimtaria e Z Mobiles për klientët e vet ka mbaruar në nëntor. Por pasojat e Marrëveshjes vazhdojnë të dëmtojnë Sindikatën dhe Telekomin e Kosovës.

---

<sup>9</sup> Padi dhe kërkesë për masa sigurimi, 17.7.2020, pjesa IV, para. 33–132.

<sup>10</sup> Po aty, pjesa VI.B, para. 182–186.

**C. Padia dhe kërkesa për masa sigurimi**

14. Më 17 korrik 2020, Sindikata ka parashtruar padi për vërtetimin e nulitetit të Marrëveshjes Telekom–Z Mobile. Krahas padisë, Sindikata ka kërkuar caktimin e masave të sigurimit, për të parandaluar dëmin e mëtejshëm dhe për të siguruar kërkesëpadinë.
15. Sindikata ka kërkuar masa që ia ndalojnë Z Mobile të vazhdojë Marrëveshjen ose të negociojë a të lidhë kontratë të re me Telekomin, të tjetërsojë pasuri deri në 264 milionë euro, dhe të pranojë përmbushjen e detyrimeve nga Marrëveshja.<sup>11</sup>
16. Lënda është protokolluar në Departamentin për Çështje Ekonomike të Gjykatës Themelore të Prishtinës, dhe bart numrin II.EK.nr.316/20.
17. Më 28 korrik 2020, Gjykata u ka dërguar palëve thirrje për seancë dëgjimore lidhur me kërkesën për masa sigurimi. Seanca është mbajtur më 10 gusht 2020.
18. Në seancë, Sindikata ka dorëzuar parashtresë plotësuese lidhur me masat e sigurimit. Gjithashtu ka pranuar përgjigjen e kundërshtarit, të protokolluar më 5 gusht 2020.
19. Më 10 gusht ose gjatë ditëve vijuese, Gjykata Themelore ka nxjerrë aktvendim, me të cilin ka refuzuar si të pathemeltë kërkesën e Sindikatës për masa sigurimi. Përfaqësuesit e Sindikatës kanë pranuar aktvendimin më 19 gusht 2020.

---

11 Po aty, pjesa VII, para. 187–213; Parashtresë e paditëse-propozueses, 10.8.2020.

### III. PRETENDIMET ANKIMORE

20. Sindikata po ushtron ankesë për shkelje të dispozitave të procedurës dhe për konstatim të gabuar ose të paplotë të fakteve, sipas Ligjit për procedurën kontestimore.<sup>12</sup>

#### A. Shkelje procedurale: Themeloria nuk ka arsyetuar refuzimin

21. Neni 182.2(n) LPK e quan shkelje thelbësore cilindo rast kur:

aktgjykimi [ose aktvendimi] ka të meta për shkak të të cilave nuk mund të ekzaminohen, e *sidomos* në qoftë se dispozitivi i aktgjykit është i pakuptueshëm apo kontradiktor me vetvete ose me arsyet e aktgjykit, apo nëse aktgjykimi nuk ka fare arsye apo në të nuk janë treguar fare arsye për faktet vendimtare, ose ato arsye janë të paqarta, ose kontradiktore, ose nëse për faktet vendimtare ekzistojnë kundërthënie midis asaj që në arsyet e aktgjykit thuhet për përmbajtje të dokumentit ose të procesverbalit për thëniet e dhëna në procedurë dhe të vet atyre dokumenteve ose të procesverbalit;<sup>13</sup>

22. Komentari i procedurës kontestimore sqaron këtë normë si vijon:

Me dispozitën e nenit 182, par. 2 nënpar. n) të LPK, parashihen rastet, kur vendimi i gjykatës duhet të priset gjithmonë, nëse ekzistojnë shkelje të tilla të dispozitave procedurale. Kjo dispozitë nuk përmban rregulla numerus clausus se kur një shkelje konsiderohet shkelje thelbësore të dispozitave procedurale. Shumë më tepër, kjo dispozitë parasheh një klauzolë gjenerale se kur konsiderohet një shkelje si shkelje thelbësore me rëndësi absolute me konsekuencë, që vendimi duhet të priset. Kjo del nga formulimi i dispozitës sipas së cilës «...*sidomos* ...». Me këtë nënkuptohet se me këtë dispozitë jepen shembujt tipikë se kur vendimi duhet të priset. Në rast se një shkelje e dispozitave procedurale nuk mundet dot të subsumohet nën këtë dispozitë, atëherë një shkelje e tillë mund të jetë shkelje esenciale me rëndësi relative sipas dispozitës së nenit 182, par. 1 të LPK.<sup>14</sup>

12 LPK, neni 181 lidhur me nenin 208.

13 LPK, neni 182.2(n) (theksim i shtuar).

14 Iset Morina & Selim Nikçi, *Komentar: Ligji për procedurën kontestimore*, bot. 1 (GIZ: Prishtinë, 2012), <http://jus.igjk.rks-gov.net/508/>, neni 182.2(n), f. 363 (theksimi i hequr).

23. Me fjalë të tjera, neni 182.2(n) nuk jep listë shteruese të të metave që e bëjnë aktvendimin të pakuptueshëm ose kundërthënës. Ndërkaq, sipas nenit 182.1, shkelje thelbësore mund të jetë cilido gabim proceduror që pamundëson vendimin e drejtë a të ligjshëm. Aktvendimi duhet të përmbajë arsyetimin.<sup>15</sup>
24. Sindikata ka kërkuar masa sigurimi sipas nenit 297 LPK dhe ka dëshmuar me argumente e prova secilin element të kërkesës: (1) besueshmërinë e padisë dhe (2) rrezikun e dëmit të pariparueshëm. Sindikata ka elaboruar pretendimet e veta në padi-kërkesën fillestare, në parashtrësën plotësuese dhe në seancën e 10 gushtit.<sup>16</sup> Por gjykata e shkallës së parë ka shpërfillur argumentet e Sindikatës pa treguar pse.
25. Sindikata e ka bërë padinë të besueshme, duke shpjeguar të drejtën e saj për të kërkuar vërtetimin e nulitetit të kontratës Telekom–Z Mobile dhe kompensimin e dëmit nga kontrata nule sipas ligjit.<sup>17</sup> Me prova ka dëshmuar shkaqet e nulitetit dhe vlerën e kontestit. Por Themeloria e ka quajtur të papërmbushur kushtin e besueshmërisë, pa e thënë as një fjalë për padinë, kërkesëpadinë ose provat e Sindikatës.
26. Tutje, Sindikata ka shtjelluar dëmin e pariparueshëm që i kanoset asaj dhe Telekomit të Kosovës. Ndër të tjera, Sindikata ka dëshmuar se Z Mobile nuk ka klientë aktivë, dhe kështu ka shtytje të tjetërsojë pasurinë e vet, duke e pamundësuar realizimin e kërkesëpadiës.<sup>18</sup> Gjithashtu, ka dëshmuar se Z Mobile po i kërkon Telekomit të përmbushë një varg detyrimesh që rrjedhin nga Marrëveshja e kontestuar e 2009-tës. Këto detyrime rrezikojnë falimentimin e Telekomit, çka cenon sigurinë shtetërore dhe i lë sindikalistët pa punë.<sup>19</sup> Rreziku i menjëherëshëm fundja është fakt notor; dëmi mund të ndodhë brenda pak ditësh ose javësh, dhe nuk mund të ndalet pos me urdhër gjykate. Por Gjykata Themelore nuk i ka trajtuar fare këto fakte, sado vendimtare që janë.

---

15 LPK, neni 173.

16 Padi/kërkesë, 17.7.2020, pj. VII; parashtrësë, 10.8.2020; procesverbal, 10.8.2020.

17 Ligj 04/L-077 për marrëdhëniet e detyrimeve, GZRK 16/2012, në fuqi 20.12.2012 (LMD), nenet 89, 90 dhe 95; shih dhe Ligjin mbi marrëdhëniet e detyrimeve të Jugosllavisë, GZ RSFJ 29/78, 39/85, 57/89, në fuqi 1.10.1978–19.12.2012, nenet 103, 104 e 110.

18 Parashtrësë, 10.8.2020, para. 7–8.

19 Parashtrësë, 10.8.2020, para. 9–14; Procesverbal, f. 1–2.



27. Gjykata dhe kundërshtari kanë pranuar parashtresën plotësuese, që ngërthen pretendimet kyçe të Sindikatës për masat e sigurimit. Procesverbali i seancës rikujton se i autorizuari i Sindikatës «gjykatës i dorëzoi në dy kopje parashtresën e palës propozuese e cila ka të bëjë me besueshmërinë e padisë, demin e pariparueshëm, falimentimin dhe sigurinë shtetërore të Kosovës».<sup>20</sup> Por në aktvendim, Gjykata Themelore nuk ka cekur fare parashtresën, as ka diskutuar pretendimet që Sindikata ka bërë në parashtresë dhe në seancë.
28. Kështu Themelorja ka nxjerrë aktvendim me arsyetim të mangët, që njëherësh bie ndesh me atë që është thënë në shkresat e lëndës. Për këto arsye, shkalla e parë është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave procedurale, andaj Gjykata e Apelit duhet ta ndryshojë në tërësi aktvendimin.

**B. Themelorja ka shkelë normat për masa sigurimi: s'ka çmuar besueshmërinë e padisë, ka mohuar masat e lejuara**

29. Apeli miraton ankesën kur shkalla e parë shkel dispozitat procedurale. Neni 182.1 LPK i quan thelbësore shkeljet procedurale që pengojnë vendimin e drejtë e të ligjshëm.
30. Në kontestin tonë, zbatimi i gabuar i dispozitave për masat siguroese ka prodhuar vendim të padrejtë. Themelorja ka aplikuar gabimisht nenin 297.1 LPK, duke mos vlerësuar besueshmërinë e padisë, si dhe nenet 299 e 301, duke mos caktuar masa të lejuara shprehimisht me ligj. Njëherësh ka cenuar të drejtat e Sindikatës shkaku i veprimeve të Telekomit, dhe ka cituar dispozita që nuk vlejnë fare për rastin tonë.

***Në vend të besueshmërisë së padisë ka trajtuar masat e propozuara***

31. Neni 297.1 LPK parasheh dy elemente të kërkesës për masa sigurimi:
- a) [...] propozuesi i sigurimit e bënë të besueshme ekzistimin e kërkesës apo të së drejtës subjektive të tij, dhe
  - b) [...] ekziston rreziku se pa caktimin e masës së këtillë pala kundërshtare do të mund ta pamundësonte apo vështirësonte dukshëm realizimin e kërkesës, sidomos me tjetërsimin e pasurisë së vet, me fshehjen e saj, me ngarkimin apo me ndonjë mënyrë tjetër, me të cilën do ta ndryshonte gjendjen ekzis-

---

20 Procesverbal, f. 1, para. fundit.

tuese të gjërave, ose në ndonjë mënyrë tjetër do të ndikonte negativisht në të drejtat e propozuesit të sigurimit.

32. Masa e sigurimit vendoset pa garanci për dëmet që mund t'i shkaktojë masa, nëse propozuesi nuk është në gjendje ta paguajë garancinë.<sup>21</sup>
33. Këtu, Sindikata ka argumentuar për besueshmërinë e padisë në dy parashtrës dhe në seancë.<sup>22</sup> Por Gjykata ka mohuar besueshmërinë e padisë, duke mos u marrë me padinë fare; në vend të saj, ka shtjelluar pa vend disa masa të propozuara (por jo të gjitha).<sup>23</sup>
34. Me këtë kapërcim, shkalla e parë nuk ka zbatuar nenin 297.1(a) për besueshmërinë e padisë ose kërkesës. Duke u përqendruar në natyrën e masave të propozuara, Themeloria ka rrëshqitur drejt materies së ne-neve 299 e tutje, që parashohin llojet e masave siguroese.

### ***Ka konsideruar të paligjshme masat e parapara me ligj***

35. Por vlerësimi i Themelores është njëlloj i gabuar sa u përket masave. Masat shërbejnë për të ruajtur rrethanat e tanishme, për të siguruar kërkesat në të holla dhe për të parandaluar dëmin e mëtejshëm.<sup>24</sup> Veçanërisht, ligji lejon këto ndër të tjera masa për kërkesat në të holla:

a) ndalimi kundërshtarit të sigurimit që ta tjetërsojë, fshehtë, ngarkojë ose disponojë me pasurinë e caktuar me vlerë të mjaftueshme për sigurimin e kërkesës së propozuesit të sigurimit. Ky ndalim do të regjistrohet në regjistrin publik përkatës;

b) ruajtja e pasurisë me të cilën ka të bëjë ndalimi nga pika e sipërme nga gjykata në depozitën e saj, kur ka mundësi për një gjë të tillë, apo duke iu dhënë në posedim propozuesit të sigurimit apo personit të tretë;

c) ndalimi debitorit të kundërshtarit të sigurimit që këtij të fundit t'i përmbushet kërkesa apo dorëzohet sendi, si dhe ndalimi kundërshtarit të sigurimit që ta pranojë sendin, ta realizojë kërkesën apo të disponojë me të;

[...].<sup>25</sup>

---

21 LPK, neni 297.3.

22 Padi/kërkesë, 17.7.2020, pj. VII; parashtrësë, 10.8.2020; procesverbal, 10.8.2020.

23 Aktvendimi, f. 5.

24 LPK, nenet 299, 301 etj.

25 LPK, neni 299.1.

36. Sa u përket rrethanave ekzistuese, ligji parasheh këto masa, ndër të tjera:
- a) ndalimi kundërshtarit të sigurimit që t'i kryejë aktivitetet e caktuara, po urdhri që t'i kryejë aktivitetet e tilla, me qëllim të ruajtjes së gjendjes ekzistuese apo pengimit të dëmtimit të palës kundërshtare;  
[...]
  - c) lënia e pasurisë së caktuar të kundërshtarit të sigurimit për ruajtje dhe përkujdesje personit të tretë;
  - d) dhe masa tjera të cilat i cakton gjykata si të domosdoshme për sigurimin e kërkesëpadisë së propozuesit të sigurimit.<sup>26</sup>
37. Thënë shkurt, masat nuk kufizohen në veprimet e parapara shprehimisht me ligj, por mund të caktohen sipas rrethanave të rastit.
38. Siç ka theksuar Sindikata në seancë, masat siguroese nuk paragjykojnë të drejtat e palëve, por parandalojnë dëmin dhe sigurojnë realizimin e kërkesëpadisë.<sup>27</sup> Masa mund të caktohet ndaj pronës a pasurisë, qoftë dhe kur e drejta mbi të është e pakontestueshme. Sipas ligjit, gjykata kufizon përkohësisht ushtrimin e së drejtës për ta tjetërsuar pronën, ia beson posedimin e pasurisë propozuesit ose personit të tretë, ia ndalon kundërshtarit të pranojë sendin dhe vë masa të tjera të domosdoshme.<sup>28</sup>
39. Duke u thirrur gabimisht në nenin 297 LPK, shkalla e parë nuk ka pranuar të vërë as masat që parashihen shprehimisht në nenet 299 e 301. Masat që ka propozuar Sindikata janë pikërisht të kësaj natyre. Për shembull, Sindikata ka kërkuar që Z Mobiles t'i ndalohej negociimi i një kontrate, pra i një aktiviteti të caktuar, sipas nenit 301(a). Ka kërkuar mandej që t'i ndalohej tjetërsimi i pasurisë, sipas nenit 299.1(a), dhe realizimi i kërkesave ndaj Telekomit, siç lejon neni 299.1(c).
40. Masat nuk paragjykojnë të drejtat e Z Mobiles, pa marrë parasysh si i ka fituar ato Z-ja. E drejta mbi sendin mund të fitohet me veprim të ligjit, me vendim gjyqësor ose me punë juridike. Andaj, nuk duhet fare me përmendë vendimin e arbitrazhit dhe procedurën përmbarimore; masat mund të shënjestrojnë krejt pasurinë e kundërshtarit.<sup>29</sup>

---

26 LPK, neni 301.

27 Prosesverbal, f. 3, para. 4.

28 Shih LPK, nenet 299.1 dhe 301.

29 Shih Aktvendimin, f. 5, para. parafundit.

***Ka mohuar të drejtat e Sindikatës shkaku i palëve të tjera***

41. Sindikata rikujton se nuk ka qenë palë në asnjë procedurë kundër Z Mobiles deri tani. Duke u thirrur në procedura arbitrazhi e përmbarimi, Gjykata Themelore padrejtësisht ka supozuar se Sindikata nuk ka shfrytëzuar mjetet juridike kur është dashur t'i shfrytëzojë. Themelorja madje nënkupton se Sindikata paska qenë «debitor» i Z Mobiles.<sup>30</sup> Por dy palët asnjëherë nuk janë përballur në një ecuri juridike; në procedurë kanë qenë Telekomit e Z Mobile.
42. Me lënë tani Sindikatën pa masë sigurimi shkaku i veprimeve të Telekomit domethënë mohim i së drejtës për padi. Ligjvënësi ka paraparë që edhe palët e treta të parashtrojnë padi për vërtetim nuliteti,<sup>31</sup> çka nënkupton se veprimet e Telekomit nuk mund t'i mvishen paditësit.

***Ka dalë jashtë kërkesës: Sindikata s'ka lypë masa nga neni 300***

43. Sindikata ka kërkuar masa sigurimi nga nenet 299 dhe 301 LPK. Duke u thirrur në nenin 300, që s'lejon me përfshi objektin e kontestit në masë sigurimi, Gjykata Themelore ka dalë jashtë kufijve të kërkesës.<sup>32</sup> Kështu ka shkelur një parim themelor të procedurës kontestimore dhe ka zbatuar gabimisht normat për masat e sigurimit.
44. Këto shkelje thelbësore kanë çuar në aktvendimin e padrejtë, që ka refuzuar kërkesën për masa sigurimi. Apeli duhet t'i sanojë shkeljet, duke ndryshuar në tërësi aktvendimin e Themelores.

**C. Keqkonstatimi i fakteve: Sindikata e Telekomit rrezikohen nga kërkesat e Z Mobiles, tjetërsimi i pasurisë dhe falimentimi**

45. Konstatimi i gabuar ose gjysmak i fakteve ndodh «kur gjykata gabimisht e ka vërtetuar ndonjë fakt vendimtar, përkatësisht kur faktin e tillë nuk e ka vërtetuar fare».<sup>33</sup> Në rastin tonë, shkalla e parë s'është marrë fare me faktet që dëftojnë rrezikun e dëmit të pariparueshëm. Kështu ka dështuar të vërtetojë faktet vendimtare që lypsen për masa sigurimi sipas nenit 297 LPK.

---

30 Po aty, f. 5, para. fundit.

31 LMD, neni 95.

32 Shih LPK, neni 2.1.

33 LPK, neni 183.1.

46. Sindikata ka dëshmuar rrezikun që Z Mobile të tjetërsojë pasurinë e vet, dhe kështu ta pamundësojë ose ta vështirësojë realizimin e kërkesëpadisë. Si provë Sindikata ka propozuar vendimin administrativ që Z Mobiles i ka marrë numrat e telefonisë, duke e lënë pa klientë aktivë.<sup>34</sup> Kjo rrethanë e bën të pamohueshëm rrezikun që kundërshtari i propozimit të tjetërsojë pasurinë apo të tërheqë kapitalin jashtë vendit. Por Gjykata Themelore e ka mohuar këtë rrezik prerazi, pa cekë qoftë një arsye të vetme.
47. Sindikata ka përimitësuar rrethanat që çojnë në dëm të mëtejshëm ndaj sindikalistëve dhe ndaj ndërmarrjes ku ata punojnë. Gjykata nuk i ka përmendur këto rrethana fare. Me fjalë të tjera, nuk i ka konstatuar faktet që janë vendimtare për miratimin ose refuzimin e kërkesës nga neni 297 LPK.
48. Padia për vërtetim nuliteti bëhet për shkelje të rendit publik, dispozitive urdhëruese dhe moralit të shoqërisë.<sup>35</sup> Rrjedhimisht, vlerësimi i gjykatës nuk kufizohet vetëm në dëmin ndaj Sindikatës, por edhe ndaj palëve të tjera. Shkalla e parë ka shpërfillur edhe rrezikun ndaj sigurisë shtetërore dhe industrisë së telekomunikacionit.<sup>36</sup>
49. Duke anashkaluar faktet kyçe, Gjykata Themelore ka dhënë konstatim të gabuar ose jo të plotë të gjendjes faktike. Gjykata e Apelit duhet të vërejë gabimet e shumëfishta të Themelores, dhe aktvendimin e saj ta ndryshojë në tërësi, duke caktuar masat e sigurimit që ka kërkuar Sindikata kundër rreziqeve ndaj punëtorëve, ndaj Telekomit të Kosovës dhe ndaj sigurisë shtetërore.

---

34 Parashtrësë, 10.8.2020, para. 7–8.

35 LMD, neni 89.

36 Shih parashtrësën, 10.8.2020, para. 11–14.

#### IV. PËRMBYLLJE DHE PROPOZIM

50. Sindikata ka ngritur padi për të vërtetuar pavlefshmërinë e një kontrate mes Telekomit të Kosovës dhe Z Mobiles. Krahas padisë ka paraqitur kërkesë për masa sigurimi, sipas nenit 297 LPK. Në padinë dhe kërkesën e 17 korrikut 2020, në parashtrësën plotësuese të 10 gushtit 2020 dhe në seancën dëgjimore të mbajtur atë ditë, Sindikata ka dëshmuar besueshmërinë e padisë dhe rrezikun e dëmit të pariparueshëm.
51. Padia ka bazë juridike të qartë: neni 89 LMD lidhur me nenin 95. Ka objekt të qartë: kontrata Telekomit–Z Mobile. Ka argument të qartë: kontrata shkel rendin publik, dispozitat urdhëruese dhe moralin e shoqërisë sepse i mundëson Z Mobiles shërbime pa mbuluar koston, i cakton Telekomit detyrime e ndëshkime të shumëfishta, dhe lejon Z Mobilen të shesë nën çmim e pa kufizim, duke mbingarkuar rrjetin e Telekomit, duke dërrmuar krejt industrinë, duke dëmtuar konkurrencën e konsumatorin dhe duke cenuar sigurinë shtetërore.
52. Tutje, Sindikata ka dëshmuar dëmin e trefishtë që i kanoset asaj, Telekomit dhe palëve të treta: (1) dëmin e ri nga përmbarimi i kërkesave të Z Mobiles; (2) tjetërsimin e mundshëm të pasurisë së Z Mobiles; dhe (3) falimentimin e Telekomit që do të linte punëtorët pa punë dhe shtetin pa shërbime kyçe të komunikimeve elektronike.
53. Në këtë rrethana, Gjykata e Apelit mund të ndryshojë në tërësi aktvendimin e Themelores, që ka refuzuar kërkesën e Sindikatës, dhe masat e sigurimit t'i caktojë vetë. Rrjedhimisht, mbështetur në argumentet e kësaj ankese dhe thëniet para Gjykatës Themelore, dhe duke u thirrur në nenet 209(d) dhe 306.1 të Ligjit për procedurën kontestimore, paditëse-propozuesja e lut Gjykatën e nderuar të nxjerrë këtë:

#### AKTVENDIM

- I. **Miratohet** si e themeltë ankesa e paditëse-propozueses Federata Sindikale e Pavarur e PTK-së; **ndryshohet** në tërësi Aktvendimi i 10 gushtit 2020 i Departamentit për Çështje Ekonomike të Gjykatës Themelore të Prishtinës në lëndën II.EK.nr.316/20.

- II. **I ndalohet** të paditur-kundërpropozuesit DARDAFON.net L.L.C. që me ose në lidhje me ndërmarrjen publike Telekom i Kosovës, SH.A., ose aksionarin e saj:
- (A) të vazhdojë Marrëveshjen e mbështetjes e operatorit të rrjetit mobil virtual, lidhur me ndërmarrjen publike Telekom i Kosovës, SH.A., më 16 janar 2009, dhe përfunduar më 30 korrik 2019 (tutje «Marrëveshja e 2009-tës»);
  - (B) të negociojë për të lidhur kontratë tjetër për rrjet virtual të telefonisë mobile; dhe
  - (C) të zbatojë çfarëdo kontrate që mund të ketë lidhur gjatë kohës mes përpilimit të kërkesës së paditëse-propozueses dhe shqyrtimit të saj.
- III. **I ndalohet** të paditur-kundërpropozuesit të tjetërsojë, të fshehë, të ngarkojë ose të disponojë me pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme me vlerë deri në 264.000.000,00 euro.
- IV. **I ndalohet** të paditur-kundërpropozuesit që në cilësinë e kreditorit të kërkojë ose të pranojë nga ndërmarrja publike Telekom i Kosovës, SH.A., ose nga aksionari i saj:
- (A) përmbushjen e detyrimeve nga Vendimi final i arbitrazhit i 9 dhjetorit 2016, nxjerrë për rastin 20990/MHM pranë tribunalit të Odës Ekonomike Ndërkombëtare (ICC) sipas Marrëveshjes së 2009-tës; dhe
  - (B) përmbushjen e detyrimeve të tjera që mund të caktohen sipas Marrëveshjes së 2009-tës.
- V. **Detyrohet** i paditur-kundërpropozuesi të pezullojë të gjitha veprimet që kanë nisur në kundërshtim me këtë aktvendim.
- VI. Ky aktvendim mbetet në fuqi deri në një vendim të ri të Gjykatës.

**Përfaqësuesi i paditëse-propozueses:**

Dr. Getoar Mjeku, jur.